

BIBLIOTEKA  
SHTETIT

88H-1  
26. 92


*Illrian Zhupa*

**DIELL  
MBI  
KASKETË**

vjersha

81H-1  
2682

*Ilirian Zhupa*



DIELL  
MBI  
KASKETË

*vjersha*

SHTËPIA BOTUESE «NAIM FRASHËRI»

KOMBINATI  
POLIGRAFIK  
Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1978

Tirazhi 1500 kopje

Format 70x100/32

Stash: 2204-72

KOMBINATI POLIGRAFIK — Shtypshkronja e Re  
Tiranë, 1978

## P A R T I S É

Me qumështin e gjirit nënët na dhanë  
për Partinë dashurinë e paanë.

Kështu të gjithë mes ditësh, mes vjetësh  
Partinë e bëmë pjesë të vetes.

Pa të s'do mundnim të ecnim në jetë,  
me trupin e drejtë e hap të shpejtë.

Pa të s'do mundnim të shihnim dot drithë,  
jo në mesnatë po as në mesditë.

Do ishim të verbër me sytë në ballë,  
s'do mundnim të ngjitnim përpjetë këto shkallë.

Me qumështin e gjirit ne pimë që të vegjël  
dashurinë e pathinjur, të pavyshkur mes vjetësh!

## UDHËT E NËNTOKËS

Udhët e nëntokës  
zgjaten thellë si rrënjet,  
këtu lidhen kohërat  
këtu lindin këngët.

Kur mbi shkëmb shqiptari  
e mbështeti kokën,  
ndjeu se si zjarri  
e digjte nëntokën.

Nga krismë e dyfekut  
na erdhi liria,  
nga fitorja në fitore  
na priu Partia.

U zgjua nëntoka  
si vajza në përralla,  
kraharorin mbushur  
metale të rralla.

Pa u zgjatën udhët  
thellë si zgjaten rrënjet  
duke lidhur kohërat,  
duke lindur këngët.

## DIELL MBI KASKETË

Ja nëntoka, këngë e drita mbushur,  
dhe vagonat plot me mineral.  
Në minierë kush ende nuk është futur,  
nuk e di se ç'do të thotë lavë.

Do mendojë, po ja, diçka e nxeh të,  
zien e digjet përditë thellësive,  
minatorët me llamba mbi kasketë  
e qëmtojnë, e nxjerrin galerive.

...Por e kotë, të ndizet fantazia,  
ejani shikojeni dhe vetë,  
djersa ballit duket si shkëndija,  
ndërsa dielli ulet mbi kasketë.

## KUMBULLA NË HYRJEN E GALERISË

Mbi hyrjen e galerisë një kumbull ka mbirë,  
po kur ka mbirë s'e di asnjeri,  
mes vjetëshës eshtë rritur e heshtur,  
herë nën diell e herë nën shi.

Tani pranvera me lule e ka mbushur,  
ne hyjmë e dalim turneve nën tokë,  
ajo si një dorë e mallshme, e bukur,  
petale pranvere na shkund përmbi flokë...

## GRIMCAT E QYMYRIT

Shtrëngoj duart e shokëve dhe ndjej,  
se nga duart e mia

kalojnë tek të tyre  
grimcat e qymyrit.

Ngre sytë drejt qiellit  
dhe më duket se më ndizet ftyra  
nga grimcat e qymyrit.

Në çdo pikë gjaku të trupit tim  
ndjej të ndizen  
grimcat e qymyrit.

S'e kuptoj dot veten,  
lumturinë,  
jetën  
pa grimcat e qymyrit.

## ATË QË S'E THASHË DOT

Them se këtu ajri është i lehtë,  
galeritë janë të gjata,  
me llamba neon.

Them se këtu njerëzit janë të singertë,  
hallin e Saliut e qajnë të gjithë,  
japin një mendim.

Them se këtu njeriu përmbyss malet,  
merr prej tyre qymyrin  
e lë djersën.

Them se turnet ngatjetojnë njëri-tjetrin  
si dy të dashuruar,  
si dy miq të vjetër.

Them shumë gjëra për shokët e mi minatorë,  
prapë them dhe më duket  
...se fjalorëve u mungojnë shumë fjalë...